



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Komisioni Vlerësues** (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/02-1399 të datës 30.01.2024, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-011/01-1404 të datës 30.01.2024, të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, në mbledhjen e mbajtur me datën 22.05.2024 merr vendim për shpalljen e:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË**  
**PALUJATSHME KOMUNALE ME NUMËR TË PARCELËS 396/1– OBJEKTI I**  
**QUMËSHTORES**

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, personat fizik dhe juridik që të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale:

- 1. Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim gjendet:** në zonën kadastrale Berkoc, e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P - 70705008 – 00396 – 1 – Objekti i Qumështores.
- 2. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës:**

Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në pesëmbëdhjetë (15) vite.

**Qëllimi:**

**Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është:**

1. Funkcionalizimi i pronës;
2. Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies.

### Kushtet e veçanta:

- a) Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të pronës është 500€, në emër të qirasë mujore;
- b) Përzgjidhet oferta me çmimin më të lartë të ofruar në ankand;
- c) Në rast se në ankand ofrohen dy apo më tepër çmime më të larta dhe të njëjtat, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertave, në prani të tyre dhe të Komisionit Vlerësues.

### Kushtet e përgjithshme të ankandit publik:

1. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në pesëmbëdhjetë (15) vite.
2. **Personat juridik** të cilët marrin pjesë në këtë procedurë, ofertës duhet t'i bashkëngjisin këto dokumentacione: **Certifikatën e regjistrimit të biznesit, Vërtetimin e ATK-së mbi kryerjen e obligimeve tatimore, Vërtetimin e tatimit në pronë (të pronarit të biznesit, që nuk ka detyrime të papaguara), Vërtetimin e taksës në firmë si dhe Dokumentin që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, për përfaqësuesin e biznesit jo më e vjetër se 6 muaj).**
3. Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.
4. Shfrytëzimi i pronës mund të bëhet vetëm sipas destinimit të cilin e ka – sektorin e qumështarisë.
5. Komuna për interes të përgjithshëm në zbatim të projekteve në prona publike rezervon të drejtën të realizojë punime pa u penguar nga shfrytëzuesi.
6. Pagesat dhe obligimet e të gjitha komunalive në parcelës së bashku me objekt të qumështores barten tek shfrytëzuesi nga koha e nënshkrimit të kontratës.
7. Shfrytëzuesi i pronës ka për obligim që të funksionalizojë pronën komunale dhe të njëjtën të mbajë në funksion gjatë gjithë kohës së shfrytëzimit sipas destinimit si në pikën 4 të këtij njoftimi.
8. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb – faqe të Komunës dhe në vendet publike. **Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimat, kati përdhësë, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë, nga data **22.05.2024** deri me datë **05.06.2024** në orën 15:00h dhe të protokollohen nga Komuna.
9. **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Objekti i Komunës së Gjakovës, Rruga “UÇK” ( ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e asamblesë komunale, me datën

**07.06.2024** në fillim të orës 10:00 h, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

- 10. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:** Të informohen me procedurat e ankandit publik, të shohin pronën që jepet në shfrytëzim, të kenë qasje në dokumentacionet e pronës dhe të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- 11.** Procedurat e ankandit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.
- 12. Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** Komisioni Vlerësues brenda tre (3) ditë pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave. Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha çmimet e ofertuesve. Pas vlerësimit të ofertave në ankand publik, Komisioni vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën fituese. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike si dhe në ueb-faqen zyrtare të komunës.
- 13.** Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.
- 14.** Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.

**Gani Hajdari**  
  
**Kryesues i Komisionit Vlerësues**

